



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Në mbështetje të nenit 35, pika 1, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, të nenit 5, pika d), të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, neni 8, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të Punës, neni 2, pika 1 dhe 3 dhe neni 2, pika 3 dhe 4, neni 3, të Udhëzimit Administrativ nr.08/2014, të MASHT-it, lidhur me procedurat e zgjedhjes së Drejtorit, Komuna e Fushë-Kosovës shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës

- I. Divizioni/Njësia:** Drejtoria e Arsimit
Titulli i pozitës: Drejtor i shkollës – SHFMU “Laura Scotti”, Graboc
Lloji i pozitës: Jo karrierës
Vendi i punës: Komuna e Fushë-Kosovës
Orët e punës: 40 orë në javë
Koeficienti : 7.8
Raporton tek: Drejtori i Arsimit

Qëllimi i postit: Brenda fushës specifike të ekspertizës profesionale, kryen detyra profesionale dhe ofron shërbime dhe produkte në nivelin e ekspertit që kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të njësive organizative duke punuar me mbikëqyrje të kufizuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë e mbikëqyrjes

1. Të planifikoj, organizoj dhe mbikëqyrë punët e përgjithshme në lidhje me aktivitetet e përgjithshme institucionale;
2. Koordinon me përgjegjësi për përfshirjen dhe vijimin e të gjithë nxënësve në shkollë, duke krijuar siguri dhe mirëqenie për të gjithë nxënësit dhe personelin e shkollës;
3. Në bashkëpunim me DKA parashtron kërkesat dhe menaxhon me përgjegjësi buxhetin e shkollës;
4. Identifikon nevojën për mësimdhënës dhe personel tjetër të shkollës;
5. Bashkëpunon me këshillin e shkollave, këshillin e prindërve, me qëllim të funksionimit sa më korrekt të institucionit;
6. Është përgjegjës për organizimin e procesit mësimor;
7. Hartimin e planit të punës dhe administrimin e përgjithshëm të shkollës;
8. Kryen edhe detyra tjera të ngarkuara nga DKA.

Perioda kohore e kontratës zgjatë katër (4) vjet, me të drejtë rizgjedhje në të njëjtën pozitë në të njëjtin institucion.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Edukimi, eksperiencia, shkathtësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja

- Diplomë universitare të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar, nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për Licencimin e Mësimdhënësve);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit;
- Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje administrative ose menaxhim;
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune në arsim;
- Letër referencë nga një institucion publik kredibil (Ministria, DKA , Këshilli drejtues i shkollës apo punëdhënësi të institucioneve të larta);
- Pani zhvillimor i institucionit ku konkurron (së paku 10 faqe tekst sipas udhëzimeve të MASHT –it);
- Njohja e programeve kompjuterike (Word, Excel, Power Point, Access);
- Komunikim të mirë ndërnjerëzorë, të mos ketë pengesa ligjore (Certifikata që nuk gjendet nën hetime);
- Njohja e gjuhëve zyrtare.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpriten aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Vetëm kandidatët e përzgjedhur për listën e ngushtë do të kontaktohen .

Afati i paraqitjes së dokumenteve është 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit, duke filluar nga data **29.05.2019 deri më 12.06.2019**

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë për aplikim nuk pranohen, si dhe ato të pakompletuara do të refuzohen.

Dokumentet e kërkuara -Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:

- Certifikata e Lindjes,
 - Diploma e fakultetit të kryer për nivel përkatës,
 - Dëshmi për përvojë të punës,
 - Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit,
 - Letër referencë nga një institucion publik kredibil (Ministria, DKA , Këshilli drejtues i shkollës apo punëdhënësi të institucioneve të larta),
 - Pani zhvillimor i institucionit ku konkurron (së paku 10 faqe tekst sipas udhëzimeve të MASHT –it)
-



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



-Dëshmi që nuk është nën hetime, **si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.**

-

Kandidatët e interesuar mund t'i marrin aplikacionet për çdo ditë pune, nga ora 09:00 deri në ora 15:00, në Zyrën e Arkivit në ndërtesën e Komunës.